



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 7, datë 27/04/2021

MBI

**“PËRCAKTIMIN E PIKËZIMIT NË KONKURSET E PRANIMIT PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, nenin 74, 76 e vijim të ligjit nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nisur dhe nga propozimet e Fakulteteve të Universitetit të Arteve, bashkëlidhur këtij vendimi dhe më konkretisht shkresave të Fakultetit të Muzikës me nr. 23/1 prot., datë 01.03.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 115/1 Prot., datë 01.03.2021), Fakultetit të Artit Skenik me nr. 100 prot., datë 24.02.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 136 prot., datë 24.02.2021) dhe të Fakultetit të Arteve të Bukura me nr. 15 prot., datë 01.03.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 144 Prot., datë 02.03.2021), pasi i mori në shqyrtim dhe i diskutoi ato, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Pikët maksimale për konkurrim në një nga programet e studimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor në Fakultetet e Universitetit të Arteve të jenë **200 pikë**, me këtë ndarje:
  - a) 30% e totalit ose **60 pikë** i takojnë notës mesatare të viteve të shkollimit dhe provimeve të Maturës Shtetërore;
  - b) 70% e totalit ose **140 pikë** i takojnë rezultateve të konkursit të pranimit për secilin program të ofruar nga Universiteti i Arteve;
2. Kufiri minimal i pranimit të konkurrentëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor të jetë **90 pikë**.
3. Formula e llogaritjes së pikëve të konkursit të pranimit në Universitetin e Arteve për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor në vitin akademik 2021-2022, të jetë si më poshtë:
  - a) **P** Pikët e përgjithshme për konkurrim: **200 totali**

